



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**

**NJOFTIM PËR SHTYP**

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij më datë 14.06.2024, mori në shqyrtim rastin e njoftimit të përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërive LG – LHT Aircraft Solutions GmbH, LG – LHT Passenger Solutions GmbH dhe AerQ GmbH nga shoqëria Lufthansa Technik AG.

Aktivitetet e Lufthansa Technik AG dhe LG Electronics Inc. nuk mbivendosen as në tregjet e rrjedhës së sipërme, as në ato të rrjedhës së poshtme me aktivitetin e shoqërive target. Shoqëritë target nuk janë aktive dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri. Nisur nga sa më sipër, transaksioni i njoftuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës **me Vendimin nr.1086, datë 14.06.2024**, vendosi të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërive LG – LHT Aircraft Solutions GmbH, LG – LHT Passenger Solutions GmbH dhe AerQ GmbH nga shoqëria Lufthansa Technik AG.

Për më tepër, ju lutem konsultoni faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës në <http://caa.gov.al>